



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 14.11.2018, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datave 05.11.2018, 06.11.2018 dhe 07.11.2018.
2. Shqyrtimi nën për nën i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019” për Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme.
3. Çështje të tjera.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Andrea Marto, Adnor Shameti, Vasilika Hysi, Ervin Bushati, Ilir Xhakolli, Bashkim Fino, Klotilda Bushka, Elona Hoxha dhe Evis Kushi.

Mungojnë:

Tritan Shehu, Klajda Gjoshaj, Edi Paloka, Nard Ndoka, Klevis Balliu, Rudina Hajdari, Edmond Panariti dhe Eglantina Gjermeni.

Të ftuar:

Gazmend Barbullushi – Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme

Ilda Dega – Drejtoreshë e Financës në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

Brunilda Muka – Specialiste në Drejtorinë e Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Esjola Mullaomeri – Specialiste në Drejtorinë e Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e sotme të Komisionit për Politikën e Jashtme, datë 14.11.2018, me këtë rend dite: miratimin e procesverbaleve të datave 5, 6 dhe 7 nëntor 2018, si dhe shqyrtimin nen për nen të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019” për Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme.

Të ftuar nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme kemi zotin Barbullushi, sekretar i Përgjithshëm, dhe zonjën Dega, drejtoreshë e Financës, ndërsa nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë kemi zonjat Muka dhe Mullaymeri, respektivisht specialiste në Drejtorinë e Buxhetit.

Jam saktë, zonjusha?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull.

Keni ndonjë vërejtje për procesverbalet e mbledhjeve të datave 5, 6 dhe 7?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk keni? Atëherë, i quajmë të miratuara.

Vazhdojmë me shqyrtimin nen për nen të projektbuxhetit për vitin 2019, të asaj që lidhet me Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme.

Fjala është për ju, zoti Barbullushi.

Gazmend Barbullushi – E nderuar zonja kryetare,

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Disa ditë më parë ministri për Europën dhe Punët e Jashtme u paraqit dhe informoi komisionin e nderuar për projektbuxhetin për vitin 2019 për këtë ministri. Sot jemi këtu për ta vazhduar atë komunikim.

Unë mund të vijoj me ato detaje që ministri paraqiti...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të thosha që jemi këtu...

Mimi Kodheli – Unë nuk mendoj se kjo është e nevojshme, pasi mendoj se ministri ka qenë shterues në paraqitjen që ka bërë herën e fundit që ka qenë në komision.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në fakt, me thënë të drejtën, unë besoj që diskutimi duhej të lidhej më së shumti, për atë që sa ju ngarkoheni me këtë gjë, me projektbuxhetin që lidhet me Ministrinë e Shtetit për Diasporën, edhe një herë e përsëris, për atë që sa ju takon juve.

Dje patëm ministrin Majko në diskutim dhe ka disa pretendime të drejta nga Ministria e Shtetit për Diasporën lidhur me një shtesë, do të thosha modeste, të fondeve të tyre buxhetore.

Ajo çka dua të ndaj me ju është, nëse jam saktë, që pas mbledhjes së përbashkët ndërmjet qeverisë së Kosovës dhe qeverisë së Shqipërisë në Korçë ju keni nënshkruar një marrëveshje për ndarjen e shpenzimeve, që lidhen me qendrat kulturore për diasporën ndërmjet qeverisë së Kosovës dhe qeverisë së Shqipërisë. Bazuar në këtë marrëveshje, nga ministri Majko kërkohej të shtoheshin edhe fondet, me qëllim që të kishte një baraspeshë të dukshme për sa u përket shpenzimeve nga ana e të dyja qeverive.

Ju keni një rol këtu? Kërkoni të njëjtën gjë? Dini se kjo është e drejtë? Dini sa do të shpenzojë qeveria e Kosovës, në mënyrë që edhe ne të mund ta facilitojmë këtë proces duke kërkuar, ndoshta te ministri Ahmetaj, sigurisht nëpërmjet një kërkesë që pa dyshim do të vijë për këtë gjë nga ana e qeverisë, jo nga ne si deputetë?

Gazmend Barbullushi – Është e vërtetë, së fundi kemi marrë një kërkesë nga ministri i Shtetit për Diasporën, zoti Majko, dhe kemi filluar ta adresojmë, do të bëhet komunikimi me Ministrinë e Financave, që ky fond të na vihet në dispozicion në qoftë se kjo do të jetë formula. Në njëfarë mënyre kemi qenë edhe të paqartë nëse do të ishim ne që do ta kërkonim këtë.

Ne e kemi nënshkruar marrëveshjen, siç bëjmë në mënyrë normale, nuk po them rëndom, me përfaqësimin e shtetit. Ky element duhet adresuar. Kështu që ne do të vijojmë ta çojmë përpara.

Nuk e di nëse...

Mimi Kodheli – Pra, nuk ka asnjë projekt konkret për të kuptuar se sa do të jenë kostot e një uniteti të caktuar, në mënyrë që kjo njësi, ky unitet të mund të rritet në numër e për pasojë të...?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si e keni menduar ju?

Gazmend Barbullushi – Atëherë...

Mimi Kodheli – Keni menduar që do të ketë një fond dhe pastaj ky do të detajohet, apo nuk ka ende një projekt konkret? Pra, marrëveshja është miratuar në parim dhe do të shikohet në vazhdimësi se si do të vijohet? Nuk jam e qartë për këtë aspekt.

Gazmend Barbullushi – Edhe ne jemi në qartësim të elementeve. Është miratuar në parim që të dyja shtetet do të hapin qendra të përbashkëta (dy të tilla) dhe së fundi morëm vesh që shteti i Kosovës ka vënë në dispozicion rreth 540 mijë euro. Meqenëse janë qendra të përbashkëta, mendojmë se edhe ne duhet të vëmë në dispozicion të njëjtën shifër. Domethënë, përllogaritja e parë bëhet në këtë mënyrë krejt përafërsisht, por nuk dimë të ketë projekte konkrete, se sa do të shpenzojmë për këto dy qendra dhe se ku do të jenë.

Kështu që, me të marrë këtë letër, ne jemi vënë në lëvizje dhe po mundohemi t'i bëjmë këto përllogaritje dhe këto projekte, pastaj do të adresojmë edhe problemin e buxhetit. Kjo kërkesë ka ardhur së fundi dhe në këtë proces jemi.

Mimi Kodheli – Edhe diçka tjetër, pa ju bezdisur, dhe pastaj do t'ua kaloj fjalën kolegëve për diskutim. Me ministrin Majko folëm gjithashtu për botimet e abetareve dhe librave të tjerë në gjuhën shqipe për fëmijët e diasporës. Në gjykimin tim mendoj se nuk ka ende një databazë të saktë se sa libra të tillë kërkohen, sa është numri i fëmijëve të moshës gjashtëvjeçare në diasporë që kanë nevojë të mësojnë gjuhën shqipe sot që flasim.

Ndoshta nuk do t'i mbulonim dot të gjithë fëmijët në diasporë, kudo janë në botë, me një të rënë të lapsit, por besoj dhe shpresoj që kjo do të jetë një gjë graduale, megjithëse kur flitet për botim librash.

Shpresoj shumë që kjo të mos kthehet në një stok, në një inventar të panevojshëm, ku harxhojmë sot disa para dhe më vonë nuk dimë si t'i shpërndajmë produktet që nxjerrim nga harxhimi i parave, që pastaj historia të jetë histori shqiptare si këto tonat.

Pse po jua bëj juve këtë pyetje? Nuk do t'ia bëja dot pyetjen ministrit Majko, i cili drejton një ministri shteti me pak staf, ndërkohë që ju keni *know how*-n, eksperiencën, mundësitë, stafin apo edhe rrjetin për ta suportuar këtë ministri në këtë proces. Sigurisht, kjo kërkon shpenzime ekstra nga ana e Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, në gjykimin tim flas, dhe ndoshta ju i keni punët kaq shumë të ndara sa...

Pikërisht, se ju nënshkruani marrëveshjen dhe historia juaj mbyllet këtu, por unë nuk e kam ende të qartë se deri ku ndërhyjnë ju si suport në raport me mbarëvajtjen e punëve të Ministrisë së Shtetit për Diasporën.

Gazmend Barbullushi – Më konkretisht për librat se si kemi vepruar, sepse shpërndarja e librave ka funksionuar edhe vite më parë, kur nuk ka qenë institucioni i Ministrit të Shtetit, ne fillojmë dhe mbledhim nevojat që ato kanë, nëpërmjet ambasadave tona që në fillim të vitit: bëhemi gati për shtatorin dhe në bazë të këtyre nevojave pastaj bëjmë porositë te ministria përkatëse për arsimin. Kjo është mënyra si ka funksionuar deri tani dhe kështu

vazhdojmë të funksionojmë. Nuk po hyj te problemet që kemi ndeshur me shtetin fqinj (ai ka qenë rast i veçantë): kemi bërë transporte gjithnjë, sa herë është evidentuar një nevojë për libra. Natyrisht, kemi bërë një porosi pak më shumë për të pasur libra, sepse hera-herës del... Nuk është kaq e rregulluar në diasporë, sepse kur krijohet një klasë, është mirë që ne t'i përgjigjemi.

Edhe tani që ka një ministri më vete për Diasporën, kemi funksionuar në këtë formë. Ne jemi totalisht në funksion të kësaj ministrie dhe janë vetëm katër persona, ndërkohë që ne kemi rrjetin e ambasadave, kemi një drejtor që ka funksion të drejtpërdrejtë diasporën. Por do vazhdojmë ta mbështesim, pasi e kemi detyrim, e kemi në fushën e përgjegjësisë.

Nuk kemi pasur nevojë për shtesa për libra, sepse nuk evidentojmë, për shembull, shtesë në fëmijë. Do të zgjidhim problemin me fqinjin, se ai ka mbetur, dhe do të vazhdojmë, siç po bëjmë, të komunikojmë edhe me ministrin e Shtetit për Diasporën që t'i sqarojmë edhe këto probleme që ai ka parashtruar këtu me stafet e tij që më pastaj t'i adresojmë.

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Ka pyetje nga kolegët? Ka diskutime?

Po, zonja Hoxha.

Elona Hoxha – Faleminderit, zoti Barbullushi!

Kam vetëm një pyetje, që lidhet me kryesimin e radhës së Shqipërisë në OSBE dhe, në fakt, disa nga ambasadat me të cilat kemi zhvilluar takime e kanë shprehur si shqetësim nevojën për kapacitete në qoftë se ne do ta marrim këtë kryesim, që me shumë gjasa do ta marrim. A kemi të parashikuar një zë në buxhet në lidhje me këtë çështje? Mund të jetë diskutuar, madje kërkoj ndjesë në qoftë se kjo gjë më ka shpëtuar mua.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Po, zoti Barbullushi.

Gazmend Barbullushi – Për vitin që vjen kemi parashikuar një rritje rreth 3% të buxhetit që shkon kryesisht për nevojat që do të kemi për presidencën, që mund të marrim dhe uroj ta marrim. Deri tani punët duken mirë. Ajo do të mbulojë kapacitetet, logjistikën dhe aktivitetet, pra është për gjithçka. Është paraqitur dhe është marrë miratimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për një minibuxhet ose një nënbuxhet më vete. Madje, këtu dua ta falënderoj Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për bashkëpunimin dhe marrjen parasysh! Kjo do të thotë se rreth 3% e buxhetit është parashikuar për të.

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Kolegë, unë nuk besoj se kemi nevojë të miratojmë ndonjë gjë nën për nën, sepse ne nuk diskutojmë këtu një nën specifik, por thjesht dhe vetëm lidhur me shpenzimet që i takojnë Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse ju nuk keni...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zonja Dega.

Ilda Dega – Kemi një kërkesë teknike për një ndryshim të tavaneve, një lëvizje nga programi në program, në qoftë se është e mundur të na ndihmojë komisioni juaj i nderuar.

Në momentin kur AKSHI-i mori shërbimin e mirëmbajtjes, kontrata e mirëmbajtjes së institucionit tonë kaloi tek AKSHI-i, duke na pakësuar tavanin, por është pakësuar gabim në programin buxhetor. Duam thjesht ta lëvizim nga njëri program tek tjetri.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Në tabelën e ardhur si material te ne, që, në fakt, nuk është materiali, por është projektligji dora vetë, ne kemi vetëm...

Ilda Dega – Aty keni vlerën totale.

Mimi Kodheli – Pikërisht, kemi vetëm vlerën totale që përfshin: menaxhimin, planifikimin dhe administrimin; mbështetjen diplomatike jashtë shtetit, aktivitetin diplomatik dhe konsullor të Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, si dhe mbështetjen institucionale në procesin e integritetit. Jam saktë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Por, gjithsesi, unë i ftoj kolegët Kushi dhe Bushati që ta ndjekin këtë korigjim që kërkohet nga ministria.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull, ia shkruajmë në raport.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Por që ta kenë parasysh, se mund të...

(Deputeti Fino flet pa mikrofon.)

Në rregull, quajeni të kryer. Pra, të shkruhet në raport.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër.

Faleminderit!

Nëse nuk ka ndonjë gjë tjetër nga kolegët, më komodë se kaq nuk mund të ishim.

(Deputeti Fino flet pa mikrofon.)

Në rregull. Mbledhjen e konsideroj të mbyllur.

Faleminderit! Punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA